



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË

Nr 5410/prot.

Tiranë, më 27.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1237/1, datë 09.06.2014.

SHOQËRISË "DANIEL - 06" SH.P.K
Qyteti Klos, Mat, Qarku Dibër.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Daniel - 06" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1237/1, datë 09.06.2014, për mineral kromi, në objektin "Manazdreni lindor – Shesh i Vogel", Mat, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5830, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5410, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1237/1, datë 09.06.2014, për mineral kromi, në objektin "Manazdreni lindor – Shesh i Vogel", Mat, Qarku Dibër, për arsye se nuk është kryer pagesa e rehabilitimit vjetor për vitin 2017-2018 në shumën 208 687 lekë, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Leja juaj është dhënë në bazë të Ligjit Nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gjurmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1237/1, datë 09.06.2014, për mineral kromi, në objektin "Manazdreni lindor – Shesh i Vogel", Mat, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1237/1, datë 09.06.2014, për mineral kromi në objektin "Manazdreni lindor – Shesh i Vogel", Mat, Qarku Dibër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

